



UNIVERSITETI I TETOVËS
УНИВЕРЗИТЕТ ВО ТЕТОВО | UNIVERSITY OF TETOVA

R A P O R T

PËR VETEVALUIMIN E FAKULTETIT JURIDIK

Tetovë, 2025

Fakulteti Juridik - Правен факултет - Faculty of Law
Str. Ilinden nn. 1200 Tetova, Republic of North Macedonia
www.unite.edu.mk – e-mail: law@unite.edu.mk

PËRMBAJTJA

1. Qëllimi i procesit të evaluimit.....	3
2. Përshkrimi i Fakultetit.....	4
2.1. Historiku.....	4
2.2. Misioni.....	5
2.3. Strategjitë e zhvillimit.....	5
3. Struktura organizative e Fakultetit.....	14
3.1. Organogrami.....	14
3.2. Programet studimore në Fakultetin Juridik.....	15
4. Veprimtaria mësimore-shkencore.....	18
5. Struktura e kuadrit mësimor-shkencor.....	19
6. Struktura e studentëve.....	21
6.1. Struktura e studentëve në studimet deridiplomike.....	21
6.2. Struktura e studentëve në studimet pasdiplomike.....	22
6.3. Struktura e studentëve në studimet e doktoraturës.....	24
7. Anketimi i studentëve.....	24
8. Veprimtaria shkencore dhe pjesëmarrja në projekte.....	25
9. Hapësirat dhe resurset materiale.....	30
10. Konkludimi.....	32

1. QËLLIMI I PROCESIT TË VETEVALUIMIT

Çështja e realizimit të evaluimit paraqet një dukuri mjaft me peshë në kuadër të aspektit të avancimit të procesit edukativ-arsimor. Bazuar në aktet juridike në fuqi, të cilat rregullojnë sferën e arsimit të lartë, evaluimi paraqet obligim ligjor të institucioneve të arsimit të lartë në Republikën e Maqedonisë së Veriut. Evaluimi i brendshëm i Fakultetit Juridik për vitin akademik 2019-2022 është realizuar gjatë muajit Prill-Qershor të vitit 2023. Qëllimi i vetevaluimit ishte të identifikohet gjendja momentale e Fakultetit Juridik dhe përfundimet nga i njëjti të shërbejnë si bazë e mbindërtimit të kualitetit të procesit mësimor-shkencor. Evaluimi i brendshëm u realizua nga Komisioni për vetevaluim i Fakultetit Juridik. Gjatë këtij procesi është realizuar evaluim i kuadrit mësimor në të gjitha programet studimore të Fakultetit, përfshirë Studimet e Drejtësisë, Gazetarisë, Shkencave Politike dhe studimeve të Kriminalistikës.

Në proces të evaluimit u përfshinë: vlerësimi i programeve studimore, ku përfshihet themelimi, përshkrimi dhe zhvillimi i programeve studimore; struktura e kuadrit mësimor – shkencor, përshkrimi i realizimit të mësimdhënies, vlerësimi i veprimtarisë shkencore të kuadrit mësimor, struktura e studentëve, anketimi i studentëve që vlerësojnë përmes disa komponentëve, struktura e kuadrit administrativ dhe teknik, hapësirat dhe mjetet e realizimit të procesit mësimor. Evaluimi është realizuar nga komisioni përkatës i themeluar me Vendim të Këshillit mësimor - shkencor të Fakultetit Juridik dhe me miratim të Këshillit të Rektoratit të UT-së. Ky proces ka përfshirë Fakultetin Juridik në Tetovë, si dhe programet: Gazetari, Shkenca Politike dhe Studimet e Kriminalistikës.

Pas përfundimit të procesit të evaluimit, komisioni ka dërguar në mënyrë individuale analizat që janë nxjerrë nga ky proces dhe i janë dërguar stafit të Fakultetit. Nga kjo, të gjithë profesorët janë njoftuar me rezultatet e evaluimit dhe qëndrimet e studentëve lidhur me lëndën, procesin e mbajtjes së ligjëratave, ushtrimeve, vlerësimeve gjatë procesit të evaluimit, etj.

Nga ky raport që është dërguar te profesorët e Fakultetit Juridik, stafi ka mundur që në mënyrë të drejtpërdrejtë të njihet me qëndrimet e studentëve lidhur me anët pozitive dhe anët negative, të cilat kanë qenë evidente gjatë realizimit të ligjëratave. Procesi i evaluimit, përveç se konstaton gjendjen faktike të Fakultetit lidhur me mësimdhënien dhe mësimnxënien, gjithashtu mundëson që në kohë të vërehen anomalitë dhe defektet dhe në kohë të eliminohen të njëjtat.

2. PËRSHKRIMI I FAKULTETIT

2.1. Historiku

Fakulteti Juridik është themeluar si njësi e Universitetit të Tetovës më 17 dhjetor 1994, me iniciativën e intelektualëve shqiptarë, të shoqatave dhe asociacioneve të ndryshme apolitike, arsimore dhe të gjithë dashamirëve të arsimit të lartë në vend dhe më gjerë. Zhvillimi i Universitetit të Tetovës ndahet në dy periudha:

- 1994-2003 koha historike e krijimit të tij; dhe
- Nga viti 2004 është periudha e zhvillimit institucional dhe koha e modernizimit akademik.

Nga viti 1994 deri në vitin 2004, në Fakultetin Juridik të Universitetit të Tetovës funksiononte vetëm programi studimor Juridik, si studime katërvjeçare, si dhe me plan-program të harmonizuar me fakultetet e drejtësisë të universiteteve të rajonit. Ndërsa, nga muaji janar i vitit 2004, në Kuvendin e Republikës së Maqedonisë së Veriut u miratua Ligj i veçantë për themelimin e Universitetit të Tetovës, prej nga e fitoi statusin e institucionit të lartë publik në Republikën e Maqedonisë së Veriut, me seli në Tetovë, me pesë fakultete, mes të cilëve ishte edhe Fakulteti Juridik. Deri në vitin 2007, në Fakultetin Juridik vazhduan studimet e drejtësisë së përgjithshme, me kohëzgjatje katërvjeçare.

- Me akreditimin e vitit 2007/2008, në kuadër të Fakultetit Juridik janë themeluar edhe dy programe studimore: programi studimor i Gazetarisë dhe Shkencave Politike, me kohëzgjatje të studimeve katërvjeçare. Programi studimor i Shkencave Politike, në kuadër të Fakultetit Juridik, filloi me punë në qytetin e Shkupit, ndërsa programi studimor i Gazetarisë në Tetovë, dhe i njëjti hapi edhe disperzime në qytetin e Shkupit. Po ashtu, gjatë vitit 2007/2008 filloi edhe implementimi i Sistemit të Bolonjës, më këtë edhe programi studimor i drejtësisë pësoi ndryshim, me ç'rast, tani më studimet e drejtësisë prej katërvjeçare u shndërruan në studimet trevjeçare me 180 kredi. Në vitin 2014, në kuadër të Fakultetit Juridik u themelua edhe programi studimor i Kriminalistikës.

Fakulteti Juridik është institucion publik i shkollimit të lartë dhe, si i tillë, është i hapur dhe i arritshëm për të gjithë ata, të cilët si studentë, mësimdhënës, bashkëpunëtorë, me cilësitë e veta intelektuale dhe morale, në ambientin e definuar të autonomisë universitare, të dëshmimit të

aftësive dhe cilësive, japin kontributin e vet në sferën e zhvillimit të arsimit, shkencës dhe profesionalizimit.

2.2. Misioni

Misioni i Fakultetit Juridik përfshin tendencën e krijimit të kuadrove të profesionalizuara në sferën e së drejtës, shkencave politike, gazetarisë dhe kriminalistikës. Konkretisht, qëllimi kryesor i Fakultetit është që të përgatitë kuadro të reja me kapacitet të lartë profesional, të cilët do të mund të ushtrojnë veprimtarinë e tyre në institucionet e sistemit juridik, shoqëror, si: gjykata, qeveri, ministri, kuvend, komuna, drejtori, mediat e shkruara dhe audiovizuale, agjenci të ndryshme, veprimtari në sferën e jurisprudence, avokatisë, noterisë dhe sfera të tjera të sektorit privat. Gjithashtu, misioni i fakultetit tonë është të nxjerrë kuadro të cilat do t'i plotësojnë nevojat shoqërore për integrimin e vendit në UE.

2.3. Strategjitë e zhvillimit

Në periudhën kohore gjatë vitit akademik 2019-2020, nga Fakulteti Juridik janë realizuar këto aktivitete:

- Në vitin e parë akademik 2019-2020, në Fakultetin Juridik, Programi Studimor Studime të Drejtësisë në Tetovë janë pranuar 58 studentë, në Programin Kriminalistikë 36 studentë, në Shkencat Politike 8 studentë dhe Gazetaria dhe media 7, gjithsej 109 studentë të regjistruar.
- Procesi mësimor në Fakultetin Juridik, ligjëratat dhe ushtrimet janë realizuar në harmoni me planprogramet mësimore dhe oraret përkatëse, sikurse në studimet themelore të ciklit të parë, po ashtu edhe në studimet e ciklit të dytë (master), në të gjitha programet studimore. Duhet theksuar që, në bazë të vendimit që mori Këshilli mësimor – shkencorë, realizimin e ligjëratave dhe ushtrimeve i filluam me prezencë fizike, mirëpo më vonë, për shkak të rritjes së vazhdueshme të rasteve të infektuar me virusin COVID -19 ishim të detyruar që të njëjtat t'i vazhdojmë online përmes platformës “meet”.
- Botimi i numrave 9 dhe 10 të Revistës shkencore ndërkombëtare të Fakultetit Juridik "JUSTICIA";

- Përgatitje e Planit aksional për realizimin e mësimi praktik të studentëve, si obligim i dalë nga dispozitat e Ligjit për arsim sipëror. Mirëpo, edhe pas përgatitjes së planit aksional, i njëjti nuk u realizua për shkak të pandemisë;
- Komisionet për të diplomuarit dhe transferet e studentëve e kanë realizuar veprimtarinë e tyre në mënyrë të rregullt;
- Të gjitha afatet e provimeve janë realizuar me sukses, pa zvarritje nga ana e mësimeve dhe bashkëpunëtorëve në ciklin e parë të studimeve;
- Janë përgatitur elaboratet për akreditimin e programeve të reja studimore të Fakultetit juridik, edhe atë:
 - Elaborat për studimet katërvjeçare për studimet e drejtësisë;
 - Elaborat për studimet katërvjeçare për studimet e kriminalistikës;
 - Elaborat për studimet katërvjeçare për studimet e shkencave politike;
 - Elaborat për studimet katërvjeçare për studimet e gazetarisë.
- Realizimi i Ligjëratave dhe Konsultimeve të ciklit të dytë janë bërë sipas kalendarit akademik;
- Afatet e provimeve të ciklit të dytë janë realizuar në kohën e përcaktuar, dhe mentorët vazhdimisht kanë mbajtur procesin e konsultimeve me kandidatët e tyre dhe disa kanë realizuar edhe mbrojtjen publike të temave të masterit, mbrojtjet janë realizuar me prezencën fizike duke respektuar masat e qeverisë për mbrojtje nga pandemia Covid 19;
- Cikli i tretë i studimeve i ka realizuar këto aktivitete:

Realizimi i Konferencave Doktorale;

Afatet e provimeve janë realizuar në kohën e përcaktuar;

Mentorët e akredituar vazhdimisht kanë mbajtur procesin e konsultimeve me kandidatët e tyre, dhe disa kanë realizuar edhe mbrojtjen publike të disertacionit të doktoraturës, duke përfshi edhe një Profesor të jashtëm, sipas Ligjit të arsimit të lartë në RMV. Disa nga mbrojtjet janë realizuar online, përmes platformës meet, duke respektuar masat e qeverisë për mbrojtje nga pandemia, përkatësisht Covid 19;

Në harmoni me Vendimin e Këshillit mësimor -shkencor të Fakultetit Juridik, është përgatitur Elaborati i ri për akreditim të studimeve të Ciklit të tretë, përkatësisht studimeve të doktoraturës, duke përfshi katër drejtime;

- Me vendim të Këshillit mësimor-shkencorë u themelua Klinika juridike dhe janë miratuar të gjitha aktet e brendshme të saja, të nevojshme për punën e mëtutjeshme;
- Në nëntor kanë filluar punët për ndërtimin e gjykatore në sallën 505, projekt i financuar nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Shkup;
- Iniciativë për anëtarësimin në Asocacionin e fakulteteve juridike të Europës ELFA (European Law Faculty Association), nga i cili anëtarësim mësimdhënësit dhe studentët e fakultetit Juridik do të kenë beneficione të ndryshme dhe mundësi për pjesëmarrje aktive në projekte të ndryshme;
- Këshilli Mësimor i Fakultetit Juridik ka realizuar mbledhjet përkatëse dhe ka shqyrtuar të gjitha kërkesat, duke sjellë aktvendimet përkatëse. Gjithsej janë realizuar 10 mbledhje të Këshillit Mësimor;
- Njëkohësisht janë realizuar të gjitha përgatitjet për mbajtjen e ligjëratave dhe ushtrimeve për semestrin veror të vitit akademik 2019-2020, mbulimin e lëndëve me mësimdhënëse dhe bashkëpunëtorë, dhe përgatitjet për realizimin e provimeve të të gjitha afateve, për të gjitha programet studimore, përfshirë edhe hartimin dhe publikimin e orareve të provimeve;
- Më datë 10.12.2020, u realizua një panel- diskutimi kushtuar Ditës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut. Tema e panel diskutimit është: “Dhuna kundër grave dhe vajzave në Maqedoninë e Veriut gjatë pandemisë Kovid-19”. Ky panel u organizua nga ana e Fakultetit Juridik - Instituti për të Drejtat e Njeriut, si dhe Macedonian American Alumni Association. Për shkak të gjendjes së pandemisë me COVID -19, i njëjti panel diskutimi u realizua përmes platformës “google meet”;
- Më 6 tetor 2020, u realizua panel diskutimi me pjesëmarrje aktive të studentëve dhe mësimdhënësve tanë, më temën “On-Line” Study Visit to North Macedonia of the European Parliament Former Members Association (FMA)”, organizuar përmes platformës online “Zoom”;
- Vizitë e studentëve nën mentorim të Prof.dr. Jusuf Zejnelit, në Komisionin shtetëror zgjedhor me rastin e Ditës Globale të zgjedhjeve;
- Ralizimi i seancës së improvizuar gjyqësore me temë: “Roli i familjes gjatë socializimit politik dhe sanksionet penale në sistemin gjyqësor”, nën mentorim të Prof.dr. Bashkim Selmani;

- Në bashkëpunim me Youth Educational Forum, Fakulteti Juridik caktoi katër ligjerata tematike në kuadër të realizimit të projektit “Forcimi i kompetencave demokratike dhe pjesëmarrja e të rinjëve” („Закнување на демократски компетенции и учество на младите луѓе“) i finansuar nga Fondacioni për demokraci Westminster (WFD). Ky aktivitet nuk kishte mundësi të realizohet, për shkak se ishte i paraparë në fillim të pandemisë COVID-19 dhe i njejt i u prolongua;
- Takim bashkëpunimi me përfaqësuesit të sektorit të Komunës së Tetovës, me qëllim të krijimit dhe përforcimit të trekëndëshit: Universiteti i Tetovës- Fakulteti Juridik - shkollat e mesme të Tetovës. Nga ky takim u caktuan realizimi i një punëtorie me Drejtorët dhe Sekretarët e shkollave fillore dhe të mesme të Tetovës me Temë “Legjislacioni dhe hartimi i akteve juridike” dhe realizimi i një seminari një ditor me nxënësit e shkollave të mesme të Tetovës, me qëllim të trajnimit të nxënësve për hartimin e akteve të ndryshme juridike, të cilët i kanë të nevojshme në jetën e përditshme. Këto dy aktivitete u prolonguan për shkak të nevojës emergjente të adaptimit të mësimi në formë online.

Në periudhën kohore gjatë vitit akademik 2020-2021, nga Fakulteti Juridik janë realizuar këto aktivitete:

- Në vitin e parë akademik 2020-2021, në Fakultetin Juridik ,Programi Studimor Studime të Drejtësisë në Tetovë, janë pranuar 75 studentë; në Programin Kriminalistikë, 44 studentë; në Shkencat Politike, 5 studentë; dhe Gazetaria dhe media, 12- gjithsej 136 studentë, me ç’rast kemi rritje të numrit të studentëve nga viti i kaluar.
- Procesi mësimor në Fakultetin Juridik, ligjëratat dhe ushtrimet janë realizuar në harmoni me plaprogramet mësimore dhe oraret përkatëse, sikurse në studimet themelore të ciklit të parë, po ashtu edhe në studimet e ciklit të dytë (master), në të gjitha programet studimore. Duhet theksuar se, në bazë të vendimit që mori Këshilli mësimor – shkencorë, realizimin e ligjëratave dhe ushtrimeve i filluam online, përmes platformës “meet”, mirëpo semestrin dimëror e realizuam me prezencë fizike, me ç’rast në vazhdimësi kemi qenë të gatshëm që të kthejmë mënyrën e mësimdhënies online, nëse numri i të infektuarve rritet ose shihet ndonjë rrezik, si për studentët ashtu edhe për stafin e fakultetit. Procesi mësimor është zhvilluar duke i respektuar masat për mbrojtje nga virusi COVID -19, të miratuara nga Qeveria.

- Botimi i numrave 15 dhe 16 të Revistës shkencore ndërkombëtare të Fakultetit Juridik "JUSTICIA";
- Përgatitje e Planit akcional për realizimin e mësimit praktik të studentëve, si obligim i dalë nga dispozitat e Ligjit për arsim sipëror. Mirëpo, edhe pas përgatitjes së planit aksional, i njëjti nuk u realizua për shkak të pandemisë;
- Është realizuar vizita e studentëve në Kazermën ushtarake të Shkupit, nën udhëheqjen e Doc.dr. Naser Etemit.
- Komisionet për të diplomuarit dhe transferet e studentëve e kanë realizuar veprimtarinë e tyre në mënyrë të rregullt;
- Administrata ka realizuar veprimtarinë e saj në mënyrë profesionale, duke shërbyer studentët me të gjitha dokumentet e nevojshme për të cilat ka kompetenca t'i lëshojë.
- Të gjitha afatet e provimeve janë realizuar me sukses, pa zvarritje, nga ana e mësimdhënësve dhe bashkëpunëtorëve në ciklin e parë të studimeve;
- Janë përgatitur dhe miratuar elaboratet për akreditimin e programeve të reja studimore të ciklit të parë të Fakultetit juridik, edhe atë:
 - Elaborat për studimet katër vjeçare për studimet e drejtësisë;
 - Elaborat për studimet katër vjeçare për studimet e kriminalistikës;
 - Elaborat për studimet katër vjeçare për studimet e shkencave politike;
 - Elaborat për studimet katër vjeçare për studimet e gazetarisë;
- Realizimi i Ligjëratave dhe Konsultimeve të ciklit të dytë janë bërë sipas kalendarit akademik;
- Afatet e provimeve të ciklit të dytë janë realizuar në kohën e përcaktuar dhe mentorët vazhdimisht kanë mbajtur procesin e konsultimeve me kandidatët e tyre. Disa kanë realizuar edhe mbrojtjen publike të temave të masterit, mbrojtjet janë realizuar me prezencën fizike, duke respektuar masat e qeverisë për mbrojtje nga pandemia Covid- 19;
- Janë përgatitur dhe miratuar elaboratet për akreditimin e programeve të reja studimore të ciklit të dytë të Fakultetit juridik, edhe atë:
 - E drejta administrative dhe kushtetuese – program me 120 ECTS;
 - E drejta administrative dhe kushtetuese – program me 60 ECTS;
 - E drejta civile – program me 60 ECTS;
 - E drejta civile – program me 120 ECTS;

- E drejta penale – program me 60 ECTS;
- E drejta penale – program me 120 ECTS;
- E drejta ndërkombëtare dhe marrëdhënie ndërkombëtare – program me 120 ECTS;
- Marrëdhënie ndërkombëtare dhe studime evropiane – program me 60 ECTS.

Cikli i tretë i studimeve i ka realizuar këto aktivitete:

- Realizimi i Konferencave Doktorale;
- Afatet e provimeve janë realizuar në kohën e përcaktuar;
- Mentorët e akredituar vazhdimisht kanë mbajtur procesin e konsultimeve me kandidatët e tyre dhe disa kanë realizuar edhe mbrojtjen publike të disertacionit të doktoraturës, duke përfshi edhe një Profesorë të jashtëm sipas Ligjit të arsimit të lartë në RMV, disa nga mbrojtjet janë realizuar online përmes platformës “meet”, duke respektuar masat e qeverisë për mbrojtje nga pandemia përkatësisht Covid- 19;

Në harmoni me Vendimin e Këshillit mësimor shkencor të Fakultetit Juridik, është përgatitur Elaborati i ri për akreditim të studimeve të Ciklit të tretë përkatësisht studimeve të doktoraturës, duke përfshi katër drejtime.

- Kemi formuar komision të ri për evaluim, i cili është duke përgatitur raportin e vlerësimit të progresit të brendshëm të fakultetit Juridik në përgjithësi;
- Në kuadër të klinikës, që është themeluar me vendim të këshillit mësimor-shkencorë, janë bërë përgatitjet e nevojshme për të vënë në praktikë nga disa lëndë të programeve të ndryshme studimore nga Fakulteti Juridik. Njëkohësisht kemi filluar fazën e parë për ta realizuar këtë projekt konkret përmes klinikës juridike.
- Në nëntor kanë filluar punët për ndërtimin e gjykatores në sallën 505, projekt i financuar nga Ambasada e Shteteve të Bashkuara në Shkup. Është bërë promovimi i klinikës juridike me organizimin e një seance të improvizuar nga studentët e Fakultetit Juridik, nën mentorimin e avokatit Ibrahim Bajrami;
- Anëtarësimin në Asociacionin e fakulteteve juridike të Europës ELFA (European Law Faculty Association), nga i cili anëtarësim mësimdhënësit dhe studentët e fakultetit Juridik kanë beneficione të ndryshme dhe mundësi për pjesëmarrje aktive në projekte të ndryshme.

- Këshilli Mësimor i Fakultetit Juridik ka realizuar mbledhjet përkatëse dhe ka shqyrtuar të gjitha kërkesat, duke sjellur aktvendimet përkatëse; gjithsej janë realizuar 10 mbledhje të Këshillit Mësimor;
- Është organizuar dhe realizuar Konferencë e përbashkët shkencore ndërkombëtare e Fakultetit Juridik të UT-së, Fakulteti Juridik i Universitetit “Haxhi Zeka” – Pejë dhe Fakulteti Juridik i Universitetit të Shkodrës “Luigj Gurakuqi”;
- Shënimi i ditës ndërkombëtare për të drejtat e njeriut, më 10.12.2021, ku në auditor kemi patur përfaqësues të fusha të ndryshme;
- Është angazhuar vizitë profesorësh nga SHBA, respektivisht vizita nga Prof. Jim Lofton në semestrin dimëror, me çka studentëve të lëndëve të ndryshme u kemi mundësuar që të ndjekin mësim për përvojën amerikane të temave të ndryshme;
- Angazhimi i një pjese të stafit për të ligjëruar në Universiteti i Osjekit “Josip Juraj Strossmayer” përmes programit Erasmus+;
- Delegacioni i BE-së për pjesëmarrjen e studentëve nga F. Juridik në debatin virtual me Ambasadorin e BE-së dhe atë të SHBA-së, me temë: Antikorrupsioni dhe reformat në sektorin e drejtësisë;
- Pjesëmarrje e studentëve të Fakultetit Juridik në takimin me Kryetarin e Parlamentit Evropian Dr. Hans-Gert Pöttering, ku kanë diskutuar në temën: On-Line' Study Visit to North Macedonia of the European Parliament Former Members Association (FMA). Takim diskutimi është organizuar për shënimin e Ditës së Evropës.

Në periudhën kohore gjatë vitit akademik 2021-2022 nga Fakulteti Juridik janë realizuar këto aktivitete:

- Në vitin e parë akademik 2021-2022, në Fakultetin Juridik- Programi Studimor “Studime të Drejtësisë” në Tetovë janë pranuar 69 studentë; në Programin Kriminalistikë 49 studentë, në Shkencat Politike 5 studentë dhe Gazetaria dhe media 2, gjithsej 125 studentë, me çka kemi rritje të numrit të studentëve nga viti i kaluar.
- Procesi mësimor në Fakultetin Juridik, ligjëratat dhe ushtrimet janë realizuar në harmoni me plaprogramet mësimore dhe oraret përkatëse, sikurse në studimet themelore të ciklit të parë, po ashtu edhe në studimet e ciklit të dytë- master, në të gjitha programet studimore. Duhet theksuar që, në bazë të vendimit që mori Këshilli mësimor-shkencorë, realizimin e

ligjëratave dhe ushtrimeve e realizuam me prezencë fizike, me ç' rast në vazhdimësi kemi qenë të gatshëm që të kthejmë mënyrën e mësimdhënies online nëse numri i të infektuarve rritet ose shihet ndonjë rrezik, si për studentët ashtu edhe për stafin e fakultetit.

- Botimi i numrave 17 dhe 18 të Revistës shkencore ndërkombëtare të Fakultetit Juridik "JUSTICIA";
- Përgatitje e Planit aksional për realizimin e mësimit praktik të studentëve, si obligim i dalë nga dispozitat e Ligjit për arsim sipëror. Mirëpo, edhe pas përgatitjes së planit aksional, i njëjti nuk u realizua për shkak të pandemisë;
- Trajnim i organizuar nga AURORA CDS Task Team, Universiteti i Palacky, Universiteti Vrije Amsterdam, dhe Universiteti i Tetovës me temë: Transformimi i Arsimit të Lartë me fokus në sipërmarrjen sociale dhe Diversiteti dhe Integriteti, mars, 2022;
- Mini-grant i fituar nga Universiteti Vrije Amsterdam për realizimin e projektit “Matja e perceptimit për korrupsionit të Rajonit të Pollogut”.

Dy trajnimet që janë realizu në kuadër të VU Mini-grant projektit janë:

- Integrity and Anti-Corruption Survey Development Training on Methodology I (Trajnimi i parë mbi metodologjinë e zhvillimit të pyetësorit për integritet dhe anti-korrupsion, Amsterdam, maj 2022);
- Integrity and Anti-Corruption Survey Development Training on Methodology II (Trajnimi i dytë mbi metodologjinë e zhvillimit të pyetësorit për integritet dhe anti-korrupsion, Tetovë, shtator 2022).
- Në Institutin për Trashëgimi Shpirtërore e Kulturore të Shqiptarëve-Shkup, Prof.Dr.Jusuf Zejneli, Doc.dr.Fatmir Xheladini dhe një grup prej 13 studentësh të Fakultetit Juridik morren pjesë në seancën përkujtimore “Muzgu i civilizimit” – Hyrja në krijimin e shtetit të terrorit dhe frikës;
- Është realizuar prezentimi nga ana e përfaqësuesve të Shoqatës ndërkombëtare “Të rinjtë dhe studentët për paqe”. Përmes këtij prezentimi, studentët u njoftuan për mundësitë për të avancuar paqen botërore, duke fuqizuar të rinjtë dhe studentët të bëhen qytetarë globalë përmes edukimit të karakterit dhe projekteve të paqes që mbështesin Objektivat e Zhvillimit të Qëndrueshëm të OKB-së. Organizimi i këtij prezentimi është realizuar nga ana e Prof.dr. Afet Mamuti;

- Është realizuar seminar njëditor për studentë me temë “Parlamenti (Kuvendi) si institucion themelor i të drejtës parlamentare”, në Kuvendin e RMV;
- Realizimi i vizitës së studentëve të programit studimor të Kriminalistikës në Kazermën e Tetovës. Grupi i udhëhequr nga Prof.dr.Jusuf Zejneli, Prof. dr. Muhamet Racaj dhe sekretari i Fakultetit Juridik ,Ali Salihi;
- Realizimi i vizitës në Policinë e Tetovës nga ana e studentëve të programit studimor të Kriminalistikës, me qëllim njohjen e tyre me organizimin e sektorit. Grupi i studentëve është udhëhequr nga ana e Doc.dr. Naser Etemit dhe Prof. Dr. Jusuf Zejnelit;
- Realizimi i vizitës së një grupi të studentëve të programit studimor të drejtësisë dhe kriminalistikës Gjykatës Themelore të Tetovës, në kuadër të manifestimit të ditës evropiane të drejtësisë. Grupi ka qenë nën udhëheqjen e Prof.dr. Drita M. Fazlia;
- Promovimi i Librit “Sovraniteti dhe Legjitimiteti i shtetit të Kosovës” nga autorja Dr. Sc. Salihe Saliu;
- Realizimi i konferencës përmbyllëse të Projektit “Matja e perceptimeve të nivelit të korrupsionit në institucionet publike në rajonin e Pollogut”, dhjetor 2022;
- Pjesëmarrja e studentëve në garat e organizuara në Universitetin “Goce Delçev” – Shtip, “Ditët e gjykimit të simuluar”- e mbështetur nga OSBE dhe Ambasada e SHBA-së, me ç’rast studentët tanë të Klinikës Juridike janë shpërblyer me dy çmime. Studentët kanë qenë të përgatitur nga ana e avokatit Ibrahim Bajrami dhe Doc.dr. Njomza Selimi Osmani;
- Pjesëmarrja e studentëve të programit studimor të Kriminalistikës kanë marrë pjesë në njërën nga qendrat e gjuajtjes në Shkup, nën mentorimin e gjeneralit Muhamet Racaj;
- Është formuar komisioni për përgatitje të planprogrameve njëvjeçare, të ciklit të dytë-master ,për të gjitha drejtimit;
- Komisionet për të diplomuarit dhe transferet e studentëve e kanë realizuar veprimtarinë e tyre në mënyrë të rregullt;
- Administrata ka realizuar veprimtarinë e saj në mënyrë profesionale, duke shërbyer studentët me të gjitha dokumentet e nevojshme për të cilat ka kompetenca t’i lëshojë;
- Të gjitha afatet e provimeve janë realizuar me sukses, pa zvarritje nga ana e mësimitdhënësve dhe bashkëpunëtorëve në ciklin e parë të studimeve;
- Realizimi i Ligjëratave dhe Konsultimeve të ciklit të dytë është bërë sipas kalendarit akademik;

- Afatet e provimeve të ciklit të dytë janë realizuar në kohën e përcaktuar dhe mentorët vazhdimisht kanë mbajtur procesin e konsultimeve me kandidatët e tyre dhe disa kanë realizuar edhe mbrojtjen publike të temave të masterit, mbrojtjet janë realizuar me prezencën fizike, duke respektuar masat e qeverisë për mbrojtje nga pandemia Covid -19;
- Këshilli Mësimor i Fakultetit Juridik ka realizuar mbledhjet përkatëse dhe ka shqyrtuar të gjitha kërkesat duke sjellur aktvendimet përkatëse. Gjithsej janë realizuar 10 mbledhje të Këshillit Mësimor;
- Është organizuar dhe realizuar Konferencë e përbashkët shkencore ndërkombëtare e Fakultetit Juridik të UT-së, Fakulteti Juridik i Universitetit “Haxhi Zeka” -Pejë dhe Fakulteti Juridik i Universitetit Publik “Kadri Zeka” -Gjilan;
- Është angazhuar vizitë e profesorëve nga SHBA, Prof. Jim Lofton në semestrin veror, me çka studentëve të lëndëve të ndryshme u kemi mundësuar që të ndjekin mësim për përvojën amerikane të temave të ndryshme;
- Angazhimi i një pjese të profesorëve për të ligjëruar përmes programit Erasmus+;
- Delegacioni i BE-së për pjesëmarrjen e studentëve nga Fakulteti Juridik në debatin virtual me Ambasadorin e BE-së dhe atë të SHBA-së, me temë: „Antikorrupsioni dhe reformat në sektorin e drejtësisë”.

3. STRUKTURA ORGANIZATIVE E FAKULTETIT

3.1. Organogrami

Fakulteti Juridik ka këtë përbërje të dekanatit:

- Dekani;
- Prodekani për arsim;
- Prodekani për shkencë;
- Sekretari i Fakultetit;
- Shefi i programit të Studimeve të Drejtësisë;
- Shefi i programit të Shkencave Politike;
- Shefi i programit të Gazetarisë;

- Shefi i programit të Kriminalistikës;
- Koordinator i për studime pasdiplomike;
- Koordinator i për studime të doktoratës;
- Koordinator i për ECTS.

3.2. Programet studimore në Fakultetin Juridik

Studimet e Drejtësisë

Në bazë të viteve të themelimit, programet studimore mund të paraqiten përmes tabelës së mëposhtme:

Tabela 1. Programet studimore ne Fakultetin juridik sipas vitit të themelimit

	Programi studimor	Viti i themelimi
1	Studime të Drejtësisë	3+2 (2013); 4+1 (2021)
2	Shkencat Politike	4+1 (2013); 4+1 (2021)
3	Gazetari	4+1
4	Kriminalistikë	3+2 (2014); 4+1 (2021)

Fakulteti Juridik, si njësi akademike e arsimit të lartë, është i hapur për të gjithë studentët që dëshirojnë të studiojnë. Fakulteti Juridik organizon studime sipas modelit 3+2 dhe 4+1.

Misioni i këtij Fakulteti është që juristët e ardhshëm, që do të profesionalizohen në Fakultetin Juridik, të jenë të aftë të marrin pozita dhe të zënë vende të punës në organet e jurisprudencës, edhe atë në gjyqësi, prokurori publike, në avokaturë, në administratën shtetërore, në institucionet dhe organet e ndryshme të pushtetit shtetëror dhe në sektorin privat.

Ky Fakultet synon:

- Dijen, shkencën dhe arsimimin e brezave të rinj;
- Aftësimin e studentit të gjykojë në mënyrë kritike dhe të mendojë në mënyrë analitike;
- Aftësimin e studentit për të analizuar fenomene, ngjarje, koncepte, ligje apo politika të caktuara;
- Mundësia e studentit të shprehet lirshëm dhe të rezonojë në mënyrë më të gjerë.

Për realizimin e synimeve të lartpërmendura, Fakulteti Juridik ka akredituar programet studimore përkatëse, me:

Vendim për harmonizimin dhe akreditimin e programit të studimit Shkencat Juridike në studimet e ciklit të parë në Fakultetin Juridik në Universitetin Shtetëror të Tetovës nr.12-266 / 2-1 më datë 05.04.2013:

- Studime të Drejtësisë

Vendim për harmonizimin dhe akreditimin e programeve të studimit të ciklit të parë të studimeve katërvjeçare në Fakultetin Juridik në Universitetin Shtetëror të Tetovës nr.12-344 / 2, më datë 17.01.2013:

- Studime Politike;
- Gazetaria dhe Media;

Vendim për harmonizimin dhe akreditimin e programit të studimeve të ciklit të parë të sistemit trevjeçar në Fakultetin e Drejtësisë në Universitetin Shtetëror të Tetovës nr.12-119 / 5, më datë 17.09.2014.

- Vendimi për akreditimin e programeve studimore universitare në Universitetin Shtetëror të Tetovës.

Duke u bazuar në përmbajtjen e programeve studimore, mund të dallojmë këto karakteristika:

Programi studimor Studimet e Drejtësisë

- Në kuadër të programit studimor Studimet e Drejtësisë, rreth 92% e lëndëve obligative janë në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas Kualifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit. Një lëndë është pjesërisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas këtij klasifikimi. Sa i përket lëndëve zgjedhore, rreth 83% janë plotësisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor, ndërsa 2 lëndë nuk janë aspak në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas klasifikimit të lartpërmendur.
- Në të gjitha lëndët (obligative dhe zgjedhore), kompetencat e parapara janë plotësisht në përputhshmëri me kompetencat e definuara te deskriptorët në nivel të programit studimor; respektivisht, qëllimi është orientimi i studentëve në njohjen e dukurive themelore që i ofrojnë lëndët në kuadër të këtij programi;

- Marrë në tërësi, vendosja kronologjike e lëndëve në kuadër të programit studimor Studimet e Drejtësisë relativisht është në kontinuitet të zhvillimit dhe mbindërtimit të njohurive dhe shkathtësive të studentëve.
- Duke marrë parasysh zhvillimet e fundit në fushën e shkencës, si dhe përmbajtjen dhe literaturën e ofruar, të gjitha lëndët në kuadër programit studimor në Studimet e Drejtësisë kanë nevojë për azhurnim të pjesshëm.

Programi studimor Gazetari

Në kuadër të programit studimor Gazetari, 16 lëndë obligative (rreth 63%) janë plotësisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor sipas Kualifikimit Ndërkombëtar të Fraskatit, si dhe 6 lëndë (37%) janë pjesërisht në përputhshmëri me fushën e këtij programi studimor. Prej 13 lëndëve zgjedhore, rreth 46% janë plotësisht në përputhshmëri me fushën e programit studimor, si dhe 7 lëndë (54%) janë pjesërisht në përputhshmëri me fushën e këtij programi studimor.

Definimi i kompetencave në kuadër të programeve studimore:

- Në të gjitha lëndët (obligative dhe zgjedhore), kompetencat e parapara të lëndëve janë plotësisht në përputhshmëri me deskriptorët për zhvillim të kompetencave të programit studimor; respektivisht, qëllimi është që studentët të orientohen drejt njohjes me dukuritë që i trajtojnë lëndët në kuadër të këtij programi studimor.
- Vendosja kronologjike e lëndëve të programit studimor Gazetari, relativisht është në kontinuitet të zhvillimit dhe mbindërtimit të njohurive dhe shkathtësive të studentëve.
- Aktivitetet me të cilat ngarkohen studentët, me qëllim të zhvillimit të kompetencave përkatëse në të gjitha lëndët obligative dhe zgjedhore, janë të planifikuara në përputhshmëri me numrin e kredive dhe shpërndarjen e orëve ,sipas numrit të kredive të lëndës përkatëse.

4. VEPRIMTARIA MËSIMORE-SHKENCORE

Fakulteti Juridik realizon veprimtarinë edukativo–arsimore në harmoni me Sistemin e Akumulimit dhe Transferimit të Kredive (ETCS), të akredituar në përputhje me rregullativën ligjore. Kohëzgjatja e studimeve në programet studimore të Fakultetit Juridik ka qenë e ndryshueshme ndër vite. Me akreditimin e vitit 2013 (Programi studimor i drejtësisë) dhe akreditimin e vitit 2014 (programi studimorë i kriminalistikës) zgjasnin nga tre vjet, me gjithsej 180 kredi (ECTS) të grumbulluara. Ndërsa sipas akreditimit të vitit 2013, programi studimor i Shkencave Politike dhe Gazetarisë zgjasin katër vjet dhe studentët grumbullojnë gjithsej 240 kredi (ECTS).

Gjatë vitit akademik 2020-2021 u përgatitën akreditimet e reja, të cilat filluan të aplikohen në vitin akademik 2021/2022, me çka akreditimet parapanë formën e studimeve katër vjeçare (tetë semestrale, me 240 Kredi) për të gjitha programet studimore.

Akreditimet e vitit 2021 kishin për tendencë shmangien e lëndëve opsionale në tërësi, duke ofruar vetëm një lëndë zgjedhore për semestër, ndërkohë që lëndët tjera janë obligative. Ndër kërkesat që nga përgatitja e akreditimeve ishte inkorporimi i lëndëve të cilat do të forcojnë aspektin praktik të studimeve në Fakultetin Juridik, duke i ofruar studentit mundësi që, në formë praktike, të mund të përgatitet lidhur me kërkesat e lëndës që gjithashtu mbështesin këtë ide.

Tendenca e Fakultetit Juridik është që të jetë më pranë studentëve, duke i përgatitur si në aspektin teorik, ashtu edhe në atë praktik, për të ushtruar veprimtarinë e tyre në të gjitha institucionet e sistemit juridik. Për këtë qëllim, në përputhshmëri me Ligjin për Arsim të Lartë, dhe në përputhshmëri me sistemin për ECTS të Fakultetit Juridik, dhe Statutin e Universitetit të Tetovës, që nga viti akademik 2013/2014, filloi implementimi i planit aksional për realizimin e punës praktike në institucionet me të cilat Universiteti i Tetovës, si dhe Fakulteti Juridik, ka realizuar marrëveshje bashkëpunimi. Studentët e programeve studimore të Studimeve të Drejtësisë, Shkencave Politike dhe Kriminalistikës, praktikën e realizojnë në institucionet qendrore dhe rajonale të sistemit juridik, siç janë komunat, Gjykata Themelore, burgu i Tetovës, si dhe njësitë rajonale të Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Ekonomisë. Programi studimor i Gazetarisë, praktikën e realizon nëpër mediat e vendit, respektivisht në servisin publik TVM2, në TV nacionale, TV regjionale, gazetatat dhe radiot e vendit.

5. STRUKTURA E KUADRIT MËSIMOR-SHKENCOR

Në Fakultetin Juridik, procesin mësimor e realizojnë gjithsej 44 mësimdhënës, më konkretisht 28 mësimdhënës dhe 16 bashkëpunëtorë të rregullt. Procesi i zgjedhjes dhe rizgjedhjes së kuadrit akademik në Fakultetin Juridik realizohet në përputhshmëri me kriteret e Ligjit për arsim të lartë të Republikës së Maqedonisë së Veriut dhe Statutit të Universitetit Shtetëror të Tetovës. Stafi akademik i rregullt në Fakultetin Juridik është në moshë relativisht të re, si te bashkëpunëtorët, ashtu edhe te mësimdhënësit. Kjo paraqet një përparësi të madhe për studentët, pasi ata kanë mundësi të mësojnë nga përvojat e tyre bashkëkohore të zhvillimit të shkencës. Nga numri i përgjithshëm i stafit akademik në Fakultetin Juridik dominon gjinia mashkullore me rreth 75%, kurse gjinia femërore përfaqësohet me 25% të mësimdhënësve. Diskrepancë e madhe vërehet te mësimdhënësit: vetëm 16% prej tyre janë të gjinisë femërore, ndërsa ka tendenca të balancimit gjinor te bashkëpunëtorët, ku 42% janë të gjinisë femërore.

Në Fakultetin Juridik në vitin akademik 2019/2020, 2020/ 21 dhe 2021/22 kanë qenë të angazhuar profesorë dhe bashkëpunëtorë në marrëdhënie të rregullt pune dhe me marrëdhënie të përkohshme pune. Dhe kjo është bërë me qëllim të plotësimit të nevojave për mësimdhënie në lëndë më specifike.

Tabela 2 Mësimdhënësit e rregullt dhe me kontratë në Fakultetin Juridik gjatë vitit akademik 2019/2020

Rregullt	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej
Ordinar	5	1	40-65	6	Ordinar	/	/	/	/
Inordinar	9	3	40-55	12	Inordinar	2	/	35-42	2
Docent	7	5	33-55	12	Docent	7	1	31-57	8
Gjithsej	21	9	/	30		9	1	/	10

Tabela 3 Bashkëpunëtorët e rregullt dhe me kontratë në Fakultetin Juridik gjatë vitit akademik 2019/2020

Rregullt	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej
Asistent	3	5	41/60	8	Asistent	2	6	28/37	8
Gjithsej	3	5	/	8	Gjithsej	2	6	/	8

Tabela 4 Mësimdhënësit e rregullt dhe me kontratë në Fakultetin Juridik gjatë vitit akademik 2020/2021

Rregullt	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej
Ordinar	5	1	40-65	6	Ordinar	/	/	/	/
Inordinar	9	3	40-60	12	Inordinar	2	/	35-42	2
Docent	7	5	33-55	12	Docent	7	1	31-57	8
Gjithsej	21	9	/	30		9	1	/	10

Tabela 5 Bashkëpunëtorët e rregullt dhe me kontratë në Fakultetin Juridik gjatë vitit akademik 2020/2021

Rregullt	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej
Asistent	3	6	41/60	9	Asistent	2	5	28/37	7
Gjithsej	3	6	/	9	Gjithsej	2	5	/	7

Tabela 6 Mësimdhënësit e rregullt dhe me kontratë në Fakultetin Juridik gjatë vitit akademik 2021/2022

Rregullt	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej
Ordinar	5	1	40-65	6	Ordinar	2	/	40-45	2
Inordinar	14	3	40-60	17	Inordinar	5	1	35-42	6
Docent	2	6	33-55	8	Docent	5	1	31-57	6
Gjithsej	21	10	/	31		12	2	/	14

Tabela 7 Bashkëpunëtorët e rregullt dhe me kontratë në Fakultetin Juridik gjatë vitit akademik 2021/2022

Rregullt	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej	Me kontratë	Meshkuj	Femra	Mosha	Gjithsej
Asistent	2	3	39/60	5	Asistent	2	7	28/37	9
Gjithsej	2	3	/	5	Gjithsej	2	7	/	9

Në përgjithësi, siç mund të shihet edhe nga tabelat e mësipërme, gjatë vitit akademik 2019/2020 dhe 2020/2021 përgjithësisht nuk kemi ndryshime në numrin e mësimdhënësve të punësuar në Fakultetin Juridik, me përjashtim të rritjes së numrit të asistentëve të rregullt për një person dhe uljen e numrit të asistentëve me kohë të pjesshme për një individ.

Në vitin 2021/22 kemi shtimin e numrit të mësimdhënësve të rregullt për një, dhe mësimdhënës part -time shtohen 4 individ. Sa u përket asistentëve për vitin 2021/2022, kemi ulje të numrit të asistentëve të rregullt për katër, dhe rritjen e numrit të asistentëve part-time njëjtë për katër vende.

6. STRUKTURA E STUDENTËVE

6.1. Struktura e studentëve në studimet deridiplomike

Fakulteti Juridik prezantohet para studentëve të ardhshëm në kuadër të promovimit të përgjithshëm të Universitetit Shtetëror të Tetovës. Ky proces realizohet përmes vizitave nëpër shkolla të mesme në Republikën e Maqedonisë së Veriut, por edhe përmes organizimit të ditës së hapur. Gjatë këtyre vizitave prezantohet fakulteti, përfshirë edhe programet studimore në veçanti, karakteristikat e tyre, si dhe kushtet të cilat i posedon për realizimin e plan-programeve të cilat i ofron. Pos tjerash promovimi i Fakultetit Juridik realizohet edhe në kuadër të ditëve të hapura që mbahen në hapësirat e Universitetit, me çka ofrohen materiale të ndryshme promovuese, përmes të cilave u ofrohet mundësi studentëve të ardhshëm që të njihen me stafin dhe të njihen me hapësirat ku do të realizohet mësimdhënia. Përgjatë tre viteve akademike për të cilat realizohet evaluimi, nuk mund të themi se kemi një konstantë të numrit të studentëve të regjistruar. Kjo për faktin se gjatë vitit 2019/20 në total kemi gjithsej 109 studentë, në vitin 2020/21 kemi 136 studentë ,dhe në vitin 2021/22 kemi përsëri ulje në 125 studentë. Përgjithësisht, mund të themi se ndër vite kemi rritje të numrit të studentëve në Studimet e drejtësisë dhe Kriminalistikë kurse kemi rënie në drejtimet Shkencat politike dhe Gazetari.

Tabela 8 Numri i studentëve të studimeve deridiplomike sipas programeve studimore në vitin akademik 2019/2020

	Programi studimor	Rregullt		Korrespondencë		Gjithsej	Shtetas të huaj		Nacionaliteti	
		M	F	M	F		M	F	M	F
1	Studime të drejtësisë	15	26	12	5	58	1	/	/	1
2	Shkencat politike	6	2	/	/	8	1	/	/	/

3	Gazetari	4	3	/	/	7	/	2	/	/
4	Kriminalistikë	32	4	/	/	36	1	/	1	
	Gjithsej	57	35	12	5	109	3	2	1	1

Tabela 9 Numri i studentëve të studimeve deridiplomike sipas programeve studimore në vitin akademik 2020/2021

	Programi studimor	Rregullt		Korrespondencë		Gjithsej	Shtetas të huaj		Nacionaliteti	
		M	F	M	F		M	F	M	F
1	Studime të drejtësisë	27	23	20	5	75	5	4	/	/
2	Shkencat politike	3	2	/	/	5	/		/	/
3	Gazetari	10	2	/	/	12	2	2	/	/
4	Kriminalistikë	41	3	/	/	44	/	1	/	1
	Gjithsej	81	30	20	5	136	7	7	0	1

Tabela 10 Numri i studentëve të studimeve deridiplomike sipas programeve studimore në vitin akademik 2021/2022

	Programi studimor	Rregullt		Korrespondencë		Gjithsej	Shtetas të huaj		Nacionaliteti	
		M	F	M	F		M	F	M	F
1	Studime të drejtësisë	16	25	17	11	69	6	/	7	5
2	Shkencat politike	4	/	1	/	5	/	/	/	/
3	Gazetari	1	1	/	/	2	/	/	/	/
4	Kriminalistikë	45	4	/	/	49	/	/	2	2
	Gjithsej	66	30	18	11	125	6	0	9	7

6.2. Struktura e studentëve në studimet pasdiplomike

Studimet master në Fakultetin Juridik kanë filluar në vitin akademik 2008-2009, fillimisht në drejtimin e Juridikut, për të vazhduar më pas edhe nëpër drejtimet tjera. Programet u akredituan nga Këshilli për Akreditim dhe u miratuan nga Ministria e Arsimit e RM-së në vitin

2018, kurse akreditimet e fundit aktuale në studimet e ciklit të dytë, sistemi dyvjeçar, u realizuan gjatë vitit 2021, ku ndër tjerash u akredituan edhe specializimet njëvjeçare në drejtimet: E drejta Civile, E drejta penale dhe E drejta administrative-kushtetuese.

Tabela 11 Numri i studentëve në studimet pasdiplomike në vitin akademik 2019/20

	Programi studimor	Rregullt		Gjithsej	Shtetas të huaj		Nacionaliteti	
		M	F		M	F	M	F
1	Penal	8	6	14	/	/	Shqiptar	Maqedonas
2	Civil	4	7	11	1	2	Shqiptar	
3	Administrativ	1	1	2	/	/	Shqiptar	
4	Marrëdhënie ndërkombëtare	1	1	2	1	/	Shqiptar	
5	Marrëdhënie ndërkombëtare Studime evropiane	/	/	/	/	/	/	
6	Gazetari 3+2	1		1	/	/	Shqiptar	
7	Gazetari 4+1		1	1	/	1	Shqiptar	
	Gjithsej	15	16	31	2	3	/	/

Tabela 12 Numri i studentëve në studimet pasdiplomike në vitin akademik 2020-21

	Programi studimor	Rregullt		Gjithsej	Shtetas të huaj		Nacionaliteti	
		M	F		M	F	M	F
1	Penal	12	1	13	1	1	Shqiptar	/
2	Civil	5	5	10	/	/	Shqiptar	/
3	Administrativ	2	2	4	1	/	Shqiptar	/
4	Marrëdhënie ndërkombëtare	/	1	1	/	/	Shqiptar	/
5	Marrëdhënie ndërkombëtare studime evropiane	5	1	6	/	/	Shqiptar	/
6	Gazetari	/	1	1	/	/	Shqiptar	/
	Gjithsej	24	11	35	2	1	Shqiptar	/

Tabela 13 Numri i studentëve në studimet pasdiplomike në vitin akademik 2021-22

	Programi studimor	Rregullt		Gjithsej	Shtetas të huaj		Nacionaliteti	
		M	F		M	F	M	F
1	Penal	1	4	5	/	/	Shqiptar	/
2	Civil	5	7	12	/	/	Shqiptar	Maqedonas
3	Administrativ	3	/	3	/	/	Shqiptar	/

4	Siguri dhe kriminalistik	3	1	4	/	/		/
5	Marrëdhënie ndërkombëtare studime evropiane	1	4	5	/	1	Shqiptar	/
6	Gazetari	/	/	/	/	/	Shqiptar	/
	Gjithsej	13	16	29	0	1	Shqiptar	Maqedonas

6.3. Struktura e studentëve në studimet e doktoraturës


Interesimi për regjistrim në ciklin e tretë ndër vite ka qenë shumë i madh nga ana e studentëve. Bëhet përpjekje që të plotësohen kushtet ligjore për akreditim të mësimdhënësve të rinj dhe drejtimeve të reja, me qëllim që të mundësohet edhe regjistrimi i numrit më të madh të studentëve në ciklin e tretë. Deri te Këshilli për Akreditim, Fakulteti ka përcjellur kërkesë për akreditim të programeve të reja studimore, megjithatë gjatë të tre viteve akademike për të cilat raportohet në këtë raport evaluimi, nuk kemi student të rinj të regjistruar.

7. ANKETIMI I STUDENTËVE

Vlerësim mbi procesin mësimor kanë realizuar edhe studentët e Fakultetit Juridik. Studentët janë përgjigjur në pyetësorë online për procesin e mbarëvajtjes dhe cilësisë së procesit mësimor, edhe atë veçmas për ligjërata dhe veçmas për ushtrime. Në çdo pyetje, studentët janë përgjigjur se sa pajtohen nëse një dukuri e caktuar ka qenë prezente gjatë procesit mësimor, në shkallë prej 1 që nënkupton se dukuria e caktuar nuk ka qenë aspak prezente, deri në 5 ku dukuria e caktuar ka qenë plotësisht prezente.

Studentët e Fakultetit Juridik gjithsej kanë dhënë 122 vlerësime nga të gjitha programet studimore të fakultetit. Në nivel të fakultetit, në të gjithë indikatorët, studentët kanë vlerësuar pozitivisht realizimin e procesit mësimor. Studentët, të cilët i janë nënshtruar provimeve në lëndët e vlerësuara, plotësisht pajtohen se testimi në lëndët e evaluuara është realizuar nga materiali i ofruar dhe ligjëruar (M = 4.71). Si vijim, studentët plotësisht pajtohen se në lëndët të cilat i kanë vlerësuar, fillimi dhe përfundimi i ligjëratave (M = 4.77) dhe ushtrimeve (M = 4.61) është i saktë

sipas orarit të planifikuar (grafikoni 1). Vlerësim pozitiv por me një tendencë të uljes, shprehet edhe për lidhshmërinë e materialit për përdorim praktik gjatë orëve të ligjëratave ($M = 4.50$) dhe orën e ushtrimeve ($M=4.44$). Mësimdhënësit gjatë orëve të ligjëratave kanë qenë të qartë lidhur me materialin e prezantuar ($M=4.67$), gjatë ushtrimeve niveli i qartësisë është shprehur me ($M=4.59$). Vlerësim i lartë paraqitet lidhur me nivelin e informimit të studentëve për realizimin e lëndëve gjatë ligjëratave ($M=4.67$), kurse për ushtrimet niveli i informimit shprehet me koeficientin ($M=4.50$). Nga parametrat e prezantuar mund të vërehet që si karakteristika dominante pozitive, me koeficientë të lartë të vlerësimit janë: "Saktësia e fillimit dhe mbarimit të orëve sipas orarit të përcaktuar në ushtrime dhe ligjërata"; "Testimi në lëndët e evaluuara është realizuar nga materiali i ofruar dhe ligjëruar" dhe "Niveli i qartësisë së mësimdhënësve lidhur me materialin e prezantuar".



Grafikoni 1. Vlerësimi i procesit mësimor në Fakultetin Juridik

8. VEPRIMTARIA SHKENCORE DHE PJESËMARRJA NË PROJEKTE

Vitet akademike 2019-2020, 2020-2021 dhe 2021-2022 janë shënuar nga një veprimtari e dendur kërkimore-shkencore e stafit akademik të Fakultetit Juridik, edhe pse kjo periudhë njohu kufizime për shkak të krizës sanitare COVID-19. Veprimtaria kërkimore-shkencore ka rezultuar me pjesëmarrje në rreth 100 konferenca, kongrese dhe seminare shkencore rajonale dhe ndërkombëtare, virtuale dhe me prani fizike, me prezantime të punës kërkimore-shkencore si dhe

me publikimin e punimeve shkencore në konferenca dhe revista me karakter rajonal dhe ndërkombëtar.

Gjatë tre viteve të fundit janë botuar mbi 80 punime shkencore, libra dhe kapituj librash kolektivë nga anëtarët e stafit, si autorë dhe bashkautorë. Publikimet janë shfaqur në revista shkencore dhe koleksione si *Justicia*, *Centrum*, *Vizione*, *FREEDOM - Journal for Peacebuilding and Transcultural Communication*, *Institute for Sociological, Political and Juridical Research*, *Academic Journal of Business, Administration, Law and Social Sciences*, *Balkan Journal of Interdisciplinary Research*, *Vandeplas Publishing*, *Ashburn Institute of Transnational Law Journal*, *Journal of Institute for British-Irish Studies University College*, *Heritage Journal*, *Casopis "Ljudska Prava"*, *Ulpianus* etj.

Fakulteti Juridik ka ndjekur në mënyrë të vazhdueshme grantet për projekte dhe ka aplikuar në disa prej tyre. Ka fituar projektin Tempus 144787, program studimor në master **Marrëdhëniet ndërkombëtare** (të drejtat e njeriut) në gjuhën angleze. Së fundi ka aplikuar për një projekt te Horizont 2020, ku bartës do të ishte UT-ja në bashkëpunim me Universitetin e Grazit dhe të Venecias.

Një mini grant i fituar është nga Universiteti Vrije Amsterdam, për realizimin e projektit “Matja e perceptcionit për korrupsionin në Rajonin e Pollogut”. Në kuadër të të cilit janë realizuar dy trajnime në Fakultetin Juridik:

- Integrity and Anti-Corruption Survey Development Training on Methodology I (Trajnimi i parë mbi metodologjinë e zhvillimit të pyetësorit për integritet dhe anti-korrupsion, Amsterdam, maj 2022);
- Integrity and Anti-Corruption Survey Development Training on Methodology II (Trajnimi i dytë mbi metodologjinë e zhvillimit të pyetësorit për integritet dhe anti-korrupsion, Tetovë, shtator 2022).

Projekte të tjera ku Fakulteti Juridik ka qenë pjesëmarrës përmes ekipit të tij janë: “Erasmus +”, “Measuring perceptions on corruption level at public institutions in North Macedonia” mes Vrije University Amsterdam dhe Fakultetit Juridik UT, “Joint Comparative Legal Research Project: Civil Liberties in the U.S. and in Europe - A Comparison of Cases decided by the SCOTUS and the ECtHR Spring 2020”, South Florida St. Petersburg (USFSP) and University of Tetova (UT), “Strengthening of the penitentiary system and the probation service, IPA –Project”, “Community Emergence Response Team (CERT) Project”, UTTAH University,

“Partnership Justitia, Regaining Citizen Trust, Mediations in Macedonia”, project funded by the European Union, “Online Debate-How to fight against corruptions”, Macedonia, “Multikultura” project funded by USAID, Trajnim organizuar nga AURORA CDS Task Team (Universiteti i Palacky, Universiteti Vrije Amsterdam dhe Universiteti i Tetovës) me temë: “Transformimi i Arsimit të Lartë me fokus në sipërmarrjen sociale dhe Diversiteti dhe Integriteti” - The Center for International Legal Cooperation (CILC) was contracted by the Netherlands Ministry of Foreign Affairs (MFA) to implement the project “Enhancing the efficiency, accountability and transparency of the Judicial Council in North Macedonia”, etj.

Po ashtu, ka pasur pjesëmarrje dhe konsulencë nga stafi ynë në projekte të tilla si: “Studentët e drejtësisë dhe juristët e ri – Aspektet kyçe të ndryshimeve për avancimin e të drejtave të njeriut dhe sundimi i së drejtës - RAPORTI BAZË” – organizuar nga Shoqata e juristëve të rinj dhe projekti “Regional Development Strategy of the Republic of North Macedonia 2020-2030” mbështetur nga Ambasada Zvicerane në Shkup dhe nga Ministria e Vetëqeverisjes Lokale e Republikës së Maqedonisë së Veriut. Studentët e Fakultetit Juridik kanë pasur takim me Kryetarin e Parlamentit Evropian **Dr Hans-Gert Pöttering, ku kanë diskutuar në temën: “On-Line Study Visit to North Macedonia of the European Parliament Former Members Association (FMA)”**. Takim- diskutimi është organizuar për shënimin e Ditës së Evropës. Është angazhur *visiting*-profesori nga SHBA, Prof. Jim Lofton në semestrin veror, me çka studentëve të lëndëve të ndryshme u kemi mundësuar që të ndjekin mësim për përvojën amerikane të temave të ndryshme.

Sa i përket organizimit të konferencave shkencore, Fakulteti Juridik ka qenë bashkëorganizator i konferencave shkencore ndërkombëtare:

- “The Western Balkans between the Russian Influence and the European Perspective” së bashku me Universitetin “Haxhi Zeka”, Republika e Kosovës dhe Universitetin “Kadri Zeka”, Republika e Kosovës, mbajtur në Universitetin e Tetovës më 16-18.11.2022, në të cilën kanë qene të ftuar të marrin pjesë dhe të prezantojnë hulumtimet shkencore autorë nga të gjitha vendet e rajonit.
- Konferencën e tretë ndërkombëtare (3th International Scientific Conference of Law and Arts) “Government Performance in the times of Covid 19 Pandemic: Human Rights and Educational Challenges”, së bashku me Faculty of Law and Arts nga Peja dhe Universiteti Publik i Shkodrës, 12.11. 2021.

Stafi akademik i Fakultetit Juridik ka qenë aktiv në botimin e titujve të rinj shkencorë nga lëmia e drejtësisë, gazetarisë dhe shkencave politike, gjatë viteve 2019-2022.

Tabela 14 Librat e botuar nga profesorët e Fakultetit Juridik gjatë vitit akademik 2019-2020

1.	Aurora Karameti in Médiations et migrations, f. 39-51 Koleksioni “Communication et Civilisation” A. Nader & J. Boulos (editors)	Le traitement et socio-politico- médiatique de la migration transitoire en Macédoine	L’Harmattan	Paris	2019
2.	Afrim Osmani	Fjalorit Terminologjik Juridik (maqedonisht-shqip dhe anasjelltë) Botimi i 3-të		Shkup	2020

Tabela 15 Librat e botuar nga profesorët e Fakultetit Juridik gjatë vitit akademik 2020-2021

1.	Afet Mamuti	SOCIAL SECURITY IN THE BALKANS – Health, pensions and disability insurance in the Republic of North Macedonia Vol. 2	Brill	Leiden, Netherlands	2021
----	-------------	--	-------	------------------------	------

Tabela 16 Librat e botuar nga profesorët e Fakultetit Juridik gjatë vitit akademik 2021-2022

1.	Ali Musliu dhe Ferat Polisi	Sociologjia e së drejtës. Qasjet klasike dhe moderne mbi sociologjinë e së drejtës.	Shtëpia botuese Iris – Print.	Strugë	2022
2.	Dashmir Idrizi	Challenges faced by the higher education in North Macedonia	Eliva Press	Amazon.com	2022

3.	Faton Shabani in Levent Doğan, Sedef Zeyrekli Yaş, Müge Atakan (Editors), pp. 25-53,	Mediation in the Republic of North Macedonia: A Successful Dispute Resolution Tool, chapter of the book Political, Cultural and Economic Developments in the Balkans,	Trakya University	Edirne	2022
4.	Jusuf Zejneli	Parlamentarizmi në Republikën e Maqedonisë së Veriut	Arbëria Design	Tetovë	2022
5.	Aurora Karameti	Informacioni dhe komunikimi në kohë krize	ISPN	Shkup	2022
6.	Hamdi Podvorica & Afet Mamuti	E drejta familjare	Tringa Design	Tetovë	2022
	Bashkim Selmani & Mevledin Mustafi	Sistemet bashkëkohore të sigurisë	Botues Evropa 92	Shkup	2022

Mobiliteti i stafit është po ashtu një nga prioritetet e Fakultetit Juridik me qëllim të rritjes së cilësisë së hulumtimeve shkencore. Prof. Dr. Arta Bilalli Zendeli ka ndjekur programin prestigjioz *IVPL* ne Washington D.C., financuar nga DASH.

Prof. Dr. Aurora Karameti ka ndjekur trajnimin intensiv mbi multimedian në Shkollën e Gazetarisë së Universitetit të Missourit në SHBA, në kuadër të programit *Alfred Friendly Macedonia Media Fellowship*, në *Journalism School, University of Missouri* dhe *Alfred Friendly Press Partners Institute* për tri javë në kuadër të një programi profesional dhe akademik ndërkombëtar ku ka qenë e autorizuar të kontaktojë me Dekanatin dhe ekipin e *J-School* për shkëmbim përvoja mbi zhvillimin e kurrikulave, metodologjinë e mësimdhënies, teknologjitë e reja, praktikat e shkëmbimeve ndërkombëtare etj.

Fakulteti Juridik është nderuar edhe me çmime në nivel kombëtar.

Profesor Afrim Osmani, është shpallur Fitues i çmimit shtetëror “SHËN KLIMENT OHRIDSKI” për vitin 2022.

Në garat e studenteve të Fakulteteve Juridike të MRV në kuadër të projektit “Ditët e gjykimit të simuluar”, grupi përfaqësues i studentëve të fakultetit tonë në kuadër të Klinikës Juridike është

nderuar me Çmimin e Dytë për vitin 2019. Në vitin 2022, në këto gara ekipi i fakultetit tonë fitoi Çmimin e Parë në finalën e organizuar në Universitetin e Shtipit. Udhëheqëse të projektit ishin Prof. Arta Bilalli Zendeli dhe Njomza Selimi Osmani.

Po në vitin 2022, ekipi përfaqësues i Fakultetit tonë nën drejtimin e Prof. Dr. Arta Bilalli-Zendeli arriti deri në gjysmëfinalen e konkursit rajonal të organizuar nga Fondacioni Halimi në Tiranë dhe studentja jone Mevlude Emini fitoi çmimin “Best researcher”.

9. HAPËSIRAT DHE RESURSET MATERIALE

Fakulteti Juridik ka kushte bashkëkohore për realizimin e mësimin teorik dhe praktik. Kjo më së miri mund të shihet në paraqitjen tabelare për hapësirat dhe resurset materiale që i posedon.

Tabela 17 Kushtet hapësinore në kuadër të Fakultetit Juridik

	Lloji i objektit	Njësia	Sipërfaqja në m ²	Ulëse
1.			9.850 m ²	
2.	Sipërfaqe e parashikuar për studime juridike		120m ²	
	Amfiteatër	1	80 m ²	80
	Hapësirë administrative	3	120m ²	140
	Klasë kompjuterike	1	25 m ²	20
		1	18 m ²	/
		1	30 m ²	25
3.	Kapacitete të tjera shfrytëzuese		100 m ²	
Gjithsej			9,850 m² 364 m²	265

Tabela 18 Pajisjet në dispozicion të Fakultetit Juridik

Nr.	Përshkrim i hollësishëm i pajisjeve të disponueshme nga programi studimor i Juridikut	Sasia
Përshkrim i hollësishëm i kompjuterëve		
30		
1.1.	Dell OptiPlex™ 380 MiniTower	1
1.2.	OptiPlex 380 MT Core 2Duo E7500 with VT (2.93GHz, 3M, 1066MHz FSB)	1
1.3.	Genuine Windows® 7 Professional Bonus-Windows XP Professional downgrade	1

1.4.	3GB DDR3 Non-ECC SDRAM,1066MHz, (2 DIMM)	2	
1.5.	320GB SATA 3.0Gb/s and 8MB DataBurstCache™	1	
1.6.	16X DVD+/-RW SATA, RoxioCreator™ CyberlinkPowerDVD™	1	
1.7.	ATI R.: Jdeon HD 2400 Pro 256MB single DV FullHeight	1	
1.8.	Internal Dell Business Audio Speaker	1	
1.9.	Mouse Padwith Dell Logo	1	
1.10.	Dell 5Button Premium USB OpticalBlack Mouse	1	
1.11.	EnhancedOuiekey™ USB SpacesaverBlackkeyboard	1	
1.12.	Power DVD 8.0 Software -li'ista& XP Compatible	1	
1.13.	RoxioCreator 9.0 (with Media) - XP& Vista Compatible	1	
1.14.	OptiPlexResource DVO	1	
1.15.	SystemDocs (DT Chassis} –European	1	
1.16.	3YearPartsOnlyWarranty...	1	
2.	Dell E Series E2010H 20in Wide Monitor, VGA/ DVI		30
Përshkrim i hollësishëm i laptopëve			
3.	DELL Latitude E5500		5
3.1.	Dell Vostro" 1510	1	
3.2.	Intel® Core™ 2 Duo P8800 with VT (2.66GHz, 3M L2 Cache, 1066MHz FSB)	1	
3.3.	Genuine Windows® 7 Professional with media	1	
3.4.	15.4"Widescreen WXGA 0280 x 800} DisplaywithAnti-GlareCoatina	1	
3.5.	3.0GB, DDR2-800 SDRAM, 2 DIMMS	1	
3.6.	250GB HardDrive, 5400RPM	1	
3.7.	8X DVD+/-RW w/RoxioandCyberlinkPowerDVD™	1	

3.8.	Intel(ii) IntegratedGraphics Media Accelerator X3100	1	
3.9.	External 56k V.90 Modern (USB) includingCableandAdapter	1	
3.10.	Dell"" Wireless 1395 (802.11 b/g) MiniPCICard	1	
3.11.	Dell"" Wireless 360 Bluetooth(ii) Card ROW	1	
3.12.	Primary 6-cell 58WHrLithiumIonbattery	1	
3.13.	6SW PowerAdapter (3Wire)	1	
3.14.	1MeterpowerCord (3Wire) –European	1	
3.15.	Dell™OpticalScroll Premium USB Mouse	1	
3.16.	InternalKeyboard - US/Euro (OWERTY)	1	
3.17.	EnglishDocumentation	1	
3.18.	DELL NylonCarryCase	1	
3.19.	3YearsPartsOnlyWarranty..	1	
4.	DELL Projectors 1409X		35
4.1.	Dell"" 1409X PortableProjector		
4.2.	Dell M409WX Projector		
4.2.	2YearsWhole Unit Warranty (90 dayswarrantyof the lamp)	1	
5.	Проективниплатнасодимензии 160 x 160 cm		2
6.	Dell 1320c NetworkColor Laser Printer		1
7.	Dell 1125 Multifunction Laser Printer		4

10. KONKLUDIMI

Fakulteti Juridik është ndër fakultetet që funksionon që nga themelimi i Universitetit të Tetovës, me një program studimor të përgjithshëm, si dhe prej vitit 2004 në kuadër të Universitetit Shtetëror të Tetovës. Prej vitit 2008, në kuadër të Fakultetit Juridik funksionojnë tre programe studimore, edhe atë: Programi studimor i Drejtësisë, Shkencave Politike dhe Gazetarisë, ndërsa prej vitit 2014 edhe programi studimor i Kriminalistikës.

Nëse mbështetemi të anketa e studentëve, mund të vërejmë se rezultati i saj në përgjithësi tregon një sukses për Fakultetin Juridik në tërësi dhe për programet studimore në veçanti.

Për të plotësuar kërkesat dhe nevojat e studentëve do të kishim sugjeruar:

- Informimi për pjesëmarrje nëpër konferenca, projekte, mysafirë ligjërues të realizohet edhe nëpërmjet burimeve të tjera të informimit, të cilët i përdorin më shpesh studentët;
- Zhvillimi i ushtrimeve në formë të praktikës-gjë që do t'u shërbejë më shumë studentëve;
- Krijimi i planit të koordinatorit për ECTS, që çdo fillim të vitit akademik të realizojë takim me grupet të ndryshme të studentëve të vitit të parë, me qëllim që t'u sqarohet sistemi i kredive dhe çështjet të cilat janë në interes të studentëve;
- Vendorsja e kutive në hapësirat frekuentuese, në të cilat studentët do të kenë mundësi të japin sugjerime/ankesa/lëvdata etj.;
- Zhvillimi i strategjisë për menaxhimin e të dhënave nga kutia e sugjerimeve.